



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

LIGJ

Nr. ____/2019

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.139/2015,
“PËR VETËQEVERISJEN VENDORE”**

Në mbështetje të neneve 13, 78, 81, pika 2, 83, pika 1, dhe 108 – 115 të Kushtetutës me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Pas nenit 29 shtohet neni 29/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 29/1

Funksionet e bashkive në fushën e diasporës dhe të migracionit

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

- a) Krijimin e strukturës së posaçme për diasporën dhe migracionin, për administrimin e shërbimeve në nivel vendor, si pjesë administrative e njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- b) Nxitjen e organizimeve, brenda dhe jashtë vendit, për mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm e forcimin e marrëdhënieve me diasporën dhe migrantët shqiptarë;
- c) Dhënien e ndihmës e të informacionit për çështje që lidhen me fitimin e shtetësisë shqiptare;
- ç) Dhënien e ndihmës e të informacionit për të interesuarit nga diaspora dhe migracioni për legjislacionin shqiptar në fushën e investimeve, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për çështjet e investimeve;
- d) Koordinimin e bashkërendimin e punës me ministritë përgjegjëse për punët e brendshme, për punët e jashtme dhe për diasporën, për garantimin e dhënies së ndihmës e të informacionit për çështjet që lidhen me diasporën dhe migracionin.”



Neni 2

Në nenin 44, fjalët “... 31 mars ...” zëvendësohen me fjalët “... 31 maj ...”.

Neni 2/1

Në nenin 54 bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Shkronja “e” ndryshohet me këtë përmbajtje:
“e) miraton tjetërsimin e pronave të tretëve”.
2. Pas shkronjës “e” shtohet shkronja “e/1 me këtë përmbajtje:
“e/1) miraton dhënien në përdorim të pronave të tretëve ose dhënien për zhvillim të pronës nëpërmjet bashkëpunimit me subjekte private”

Neni 2/2

Në nenin 55 pika 3, pas referencës në shkronjën “d” shtohet referenca në shkronjën “e/1”.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI